

**V E N D I M**

Nr. 54 Date 29.05.2008

**PER**

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PER LICENSIMIN E SHOQERISE "BIOPOWER  
GREEN ENERGY " SH.P.K**


Në mbështetje të neneve 9 dhe 13 pikat 1 germa a) dhe 8, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, "*Për Sektorin e Energjisë Elektrike*", te ndryshuar, nenit 10 te "Rregullores per Procedurat e Licensimit" te miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.21 datë 04.04.2007, dhe neneve 18 pika 3, dhe 19 pika 3, te Rregullave te Praktikës dhe Procedurave te ERE-s", miratuar me Vendimin e Bordit te Komisionereve Nr.44, date 24.07.2007, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 29.05.2008, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqeria "Biopower Green Energy" sh.p.k per tu licensuar ne aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit te centraleve elektrik si dhe prodhimi i energjise elektrike, (Park eolik BPGE1 dhe BPGE2, Balldren, Lezhe),

**Dhe konstatoi:**

- Paraqitjen, konform percaktimeve te Rregullores se Procedurave te Licensimit, te dokumentacionit dhe deklarave te kerkuara nga ERE kur dokumentacioni mungon,
- Parku BPGE1 perputhet me zonen e studiuar nga shoqeria ERS-08 shpk. per te cilen kane filluar procedurat e licensimit me Vendimin e Bordit te Komisionereve nr. 29, date 04.03.2008



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**ENTI RREGULLATOR I**  
**SEKTORIT TË ENERGJISË**  
**ELEKTRIKE**  
Bordi i Komisionereve



Per sa konstatoi me siper Bordi i Komisionereve te ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të filloj procedurat per licensimin e shoqerise “Biopower Green Energy” sh.p.k ne aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit te centraleve elektrik si dhe prodhimin e energjise elektrike. (Park eolik BPGE2, Balldren, Lezhe).
2. Te pezulloj procedurat e shqyrtimit te aplikimit të paraqitur nga shoqeria “Biopower Green Energy” sh.p.k, për licensimin në aktivitetin e ndertimit, instalimit dhe shfrytezimit te centraleve elektrik si dhe prodhimin e energjise elektrike (Park eolik BPGE1) deri ne marrjen konform Rregullores se procedurave te Licensimit, te vendimit përfundimtar nga Bordi i Komisionereve per aplikimin per licensim te shoqerise ERS -08 sh.p.k.
3. Ngarkohet Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit te Tregut te njoftoje aplikuesin per vendimin e Bordit te Komisionereve te ERE-s,

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**Kryetari i ERE-s**  
**Bujar Nepravishta**